

VENDIM
Nr. 366, datë 15.12.2023

**MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 74, DATË
13.4.2022**

Në mbështetje të neneve 16, 19, 20, germa “c”, 83 dhe 85, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 6, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.12.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2230/5 prot., datë 13.12.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 325, datë 14.12.2022, ka vendosur ndër të tjera: 1. të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë FSHU sh.a. për vitin 2023, për çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal ose konstatimit të ndryshimit të kostove bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- ERE, me shkresën nr. 2230 prot., datë 3.10.2023, ka sjellë në vëmendje të shoqërisë FSHU sh.a., detyrimin për të aplikuar për përcaktimin e çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, në përputhje me nenin 5, pika 3, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal” dhe nenin 21, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016.

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 6836/3 prot., datë 30.10.2023, ka bërë me dije se edhe për vitin 2024 pritet që shoqëria KESH sh.a., të vazhdojë të furnizojë me energji FSHU sh.a., me çmime të reduktuara, duke pasur si synim mosndryshimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për klientët fundorë të cilët shërbehen nga FSHU sh.a. Sipas parashikimeve të FSHU sh.a., çmimet e rregulluara të blerjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a., sigurojnë mbulim të shpenzimeve të reduktuara të FSHU sh.a. dhe një performancë minimale pozitive mbijetese. Në këto kushte, shoqëria FSHU sh.a., për vitin 2024, ka kërkuar që çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 325, datë 14.12.2022, të mos ndryshojnë.

- Në vijim, ERE, me anë të shkresës nr. 2230/2 prot., datë 15.11.2023, ka kërkuar nga shoqëria FSHU sh.a. të paraqesë në ERE të gjithë të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm lidhur me ushtrimin e aktivitetit të saj.

- Në përgjigje të shkresës së ERE me nr. 2230/2 prot., datë 15.11.2023, shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 6836/5 prot., datë 6.12.2023, ka bërë me dije se për shkak të vonesave në vlerësimin e aseteve të OSHEE Group, kryer nga shoqëria audituese “Deloitte” në vitin 2020 dhe raportuar në vitin 2021, është kërkuar që të bëhen ndryshimet dhe aprovimet e nevojshme në Pasqyrat Financiare për vitet 2020 dhe 2021, dhe procesi i auditimit të tyre bashkë me pasqyrat financiare të vitit 2022 është akoma në proces. Gjithashtu, në vijim, shoqëria ka paraqitur të dhëna sintetike në formë

tabelore, lidhur me ushtrimin e aktivitetit të saj, pa dhënë sqarimet dhe argumentet përkatëse, sikurse parashikuar në metodologjinë e përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal.

- Në mënyrë që shoqëria FSHU sh.a., edhe për vitin 2024, të mundet të realizojë aktivitetet për të cilat është licencuar, konform ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, bëhet e domosdoshme të vijojë faturimin bazuar në çmimet e miratuara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë FSHU sh.a., për vitin 2024, për çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e shoqërive, do të bëhet korrigjimi dhe kompensimi përkatës i tyre, në përputhje me përcaktimet e nenit 20, germa “c”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe metodologjive përkatëse, të miratuara nga ERE.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti